

DIXHITALIZIMI I SHËRBIMEVE PUBLIKE TË MFE



LEHTËSIMI I SHËRBIMEVE PËR BIZNESIN



SHËRBIMET ONLINE TË ADMINISTRATËS TATIMORE



DIXHITALIZIMI I SHËRBIMEVE TË OFRUARA NGA ISSH



PUNËSIMI ME NDËRMJETËSIMIN E ZYRAVE TË PUNËS



Ministria e Financave dhe Ekonomisë i është bashkuar nismës së Qeverisë për të dixhitalizuar shërbimet publike që ofrohen për qytetarët dhe bizneset nëpërmjet platformës E- albania. Gjatë 2020 janë programuar të jenë online 510 shërbime ose 94 % e të gjitha shërbimeve që ofrohen nga institucionet e varësisë të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, ku 188 shërbime bëhen efektive më 1 Janar, 270 shërbime bëhen efektive më 30 Qershor dhe 26 shërbime bëhen efektive dhjetor 2020. Vetëm 33 shërbime, ose 6 % e totalit që ofrohen nga MFE, do të ofrohen pranë sporteve të institucioneve të MFE. Punonjësit e këtyre institucioneve do të orientojnë dhe asistojnë çdo qytetar apo biznes, në lidhje me këtë transformim të rëndësishëm, i cili synon lehtësimin e praktikave dhe shkurtimin e rradhëve të pritjes.

Që nga data 1 janar 2020, Qendra Kombëtare e Biznesit ofron 114 shërbime online për biznesin. Këto shërbime grupohen në 16 kategori shërbimesh, të fokusuar në regjistrin tregtar dhe regjistrin e lejeve, licensave dhe autorizimeve.

Të gjitha shërbimet që do të aplikohen online do të kursejnë 3179 ditë pune për qytetarët dhe bizneset, ofrohen pa radhë dhe pa asnjë kosto shtesë. Ndërkohë, do të jenë punonjësit e QKB-së të cilët do të luajnë një rol më të madh në sigurimin e dokumenteve shoqëruese, me synim lehtësimin e ofrimit të shërbimit publik online ndaj qytetarit. Duke nisur që nga data 1 janar, disa shërbime do të ofrohen vetëm online, siç është ai i regjistrimit të një biznesi, ndërkohë parashikohet që të gjitha shërbimet e mbetura në Qendrën Kombëtare të Biznesit do të ofrohen online deri në 30 qershor.

Administrata Tatimore do të shtojë numrin e shërbimeve elektronike gjatë vitit 2020 dhe reduktojë ato që ofrohen në sportel. DPT ofron 11 shërbime automatike online që lëshohen elektronikisht nëpërmjet portalit e-albania, nga të cilat 9 janë për subjekte dhe 2 për individë. Në kuadër të dixhitalizimit të shërbimeve publike, Ministria Anila Denaj zhvilloi një vizitë në mjediset e Shërbimit të Tatimpaguesve në Tiranë, ku vuri në dukje se risia e vitit 2020 është integrimi i proceseve dhe sistemeve të administratës publik. Ky integrim do të ndihmojë në përdorimin sa më efektiv të kohës nga ana e individëve dhe tatimpaguesve, uljen e kostos dhe shkëmbimin sa më të saktë të informacionit. Gjatë vitit 2019, 350 mijë aplikime janë bërë nga qytetarët dhe tatimpaguesit për shërbimet online që ofrohen nga Administrata Tatimore.

Ministria e Financave dhe Ekonomisë zhvilloi një vizitë në Agjencinë e Sigurimeve Shoqërore Tiranë, ku së bashku me Drejtorin e Përgjithshëm të ISSH-së, z. Astrit Hado, informuan qytetarët mbi shërbimet e reja që do të ofrohen për ta online. Gjatë bashkëbisedimit, Ministria Denaj u shpreh se përmes ofrimit të shërbimeve në mënyrë elektronike synohet ulja e kostove dhe shmangia e rradhëve të pritjes nga qytetarët në sportele, ndërkohë që shërbimi në sportele do të vijojë të ekzistojë në zyrat e ISSH, edhe për të ndihmuar e orientuar qytetarët mbi ofrimin e shërbimeve online. Ministria bëri me dije se po punohet për të reduktuar numrin e dokumenteve që duhet të paraqesin qytetarët gjatë aplikimit për një shërbim të caktuar, ku në disa raste do të jenë vetë institucionet shtetërore ato që do të sigurojnë dokumentet e kërkuara. Numri i shërbimeve që ofrohen online nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore përmes portalit e-albania është 31.

30.400 persona janë punësuar në gjithë vendin nëpërmjet ndërmjetësimit të zyrave të Punës gjatë vitit 2019. Zyrat e Punës janë gjithmonë në shërbim të punëkërkuësve, duke përshtatur kërkesat e tyre për punësim me ofertën e tregut të punës. Në kuadër të dixhitalizimit të shërbimeve publike, edhe Shërbimi Kombëtar i Punësimit do të shtojë gjatë vitit 2020 numrin e shërbimeve që do të ofrohen online. Në fund të vitit të kaluar, SHKP zhvilloi trajnime me 165 specialistë dhe drejtues të Zyrave të Punësimit dhe Drejtorive të Formimit Profesional Publik në gjithë vendit mbi shërbimet që do të ofrohen Vetëm ONLINE për të gjithë qytetarët përmes portalit qeveritar e-Albania!